# DËSHMI ARKIVI

**A-449482**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Serbia reagon pas vendimit të Hagës: UÇK-ja ishte organizatë terroriste, dënimet nuk mjaftojnë! - Shqiptarja.com |
| ADRESA | `https://shqiptarja.com/lajm/serbia-reagon-pas-vendimit-te-hages-uckja-ishte-organizate-terroriste-dwnimet-nuk-mjaftojnw` |
| BURIMI | shqiptarja.com |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 16 shtator 2026, 14:16:24 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 16 shtator 2026, 14:15:29 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `02b7426a5ac0a1f63a5ad33816b02f42097c2f42049178026a4e3e5766d46604` |
| TEKSTI | `142d710b339d7c1c19b2802355138d954cdbcf00bef45564c0a1fd96e5355ec9` |
| PAMJA | `5e2c6c5fb4d13ba220d2f474d1ef9696bc219017370d04251a4b33a033cabd9d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7c363a874cc37ef155dd9a817be7275720f85193a0fbb8c1fd1360006f8b5d78` |
| E MËPARSHMJA | `604831d93126ccdfdf162384b59e65cd40a40efa1aab6756868c93887b4f7a0e` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7c363a874cc37ef155dd9a817be7275720f85193a0fbb8c1fd1360006f8b5d78`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kosova & Rajoni

# Serbia reagon pas vendimit të Hagës: UÇK-ja ishte organizatë terroriste, dënimet nuk mjaftojnë!

*Daçiç u ndal veçanërisht te vendimi i gjykatës për të mos i shpallur fajtorë për krime kundër njerëzimit, duke e cilësuar këtë "manovër politike".*

■ Dodik sulmon vendimin e Hagës për liderët e UÇK: Thaçi duhej dënuar edhe për krime kundër njerëzimit



*Ivica Daçiç*




Redaksia
16 Shtator, 16:12 | **Përditesimi: 16 Shtator, 14:15**

Share Tweet

Vendimi i Dhomave të Specializuara për katër ish-krerët e UÇK-së u shfrytëzua menjëherë nga Beogradi për të sulmuar sërish Kosovën. Zëvendëskryeministri serb, Ivica Daçiç, tha se aktgjykimi konfirmon, sipas tij, pretendimet e Serbisë për UÇK-në, ndërsa kritikoi ashpër rrëzimin e akuzave për krime kundër njerëzimit.

"Aktgjykimi ndaj Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit dëshmoi se UÇK-ja ishte organizatë kriminale dhe terroriste dhe se udhëheqësit e saj të lartë politikë dhe ushtarakë ishin përgjegjës për krime gjatë luftës në Kosovë", deklaroi Daçiç.

Ai u ndal veçanërisht te vendimi i gjykatës për të mos i shpallur fajtorë për krime kundër njerëzimit, duke e cilësuar këtë "manovër politike".



LEXO EDHE:
**Preç Zogaj: Dënimet në Hagë, midis solidaritetit njerëzor ndaj të akuzuarve dhe keqkuptimeve alla shqiptare për drejtësinë**

"Është e turpshme që vrasjet sistematike të serbëve nuk u cilësuan si krime kundër njerëzimit", tha Daçiç, duke shtuar se, sipas tij, edhe dënimet e shqiptuara nuk janë të mjaftueshme për familjet e viktimave serbe.

*Lajmi kryesor:*
**Vuçiç i pakënaqur me vendimin e Hagës: Nuk janë dënuar për krime kundër njerëzimit, mos festoni endel Sulmon reagimet e Regait dhe Ramës**

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 15:34

## As 81 vitet burg nuk i mjaftojnë, Dodiku sulmon vendimin e Hagës për liderët e UÇK: Thaçi duhej dënuar edhe për krime kundër njerëzimit

Edhe pse Dhomat e Specializuara dënuan me gjithsej 81 vite burg katër ish-krerët e UÇK-së, Milorad Dodik e cilësoi vendimin të papranueshëm, duke kritikuar faktin që gjykata rrëzoi akuzat për krime kundër njerëzimit.

> *"Dënimi i shqiptuar ndaj Hashim Thaçit dhe të tjerëve është një karikaturë e drejtësisë, që shërben për të relativizuar krimet kundër serbëve dhe për të amnistuar të ashtuquajturin terrorizëm të UÇK-së. Është e turpshme që vrasjet sistematike të serbëve në Kosovë e Metohi nuk u cilësuan si krime kundër njerëzimit, por del sikur ata kanë vdekur si kalimtarë të rastit. Thaçi ishte ideologu dhe udhëheqësi i një organizate terroriste, ekzekutues i drejtpërdrejtë dhe urdhërdhënës. E gjithë kjo u anashkalua. Prej kohësh e dimë se në Hagë nuk ka drejtësi dhe të drejtë, ndërsa tani e dimë përfundimisht se nuk ka as respekt dhe as mëshirë për viktimat serbe. Fakti që gjyqi u zhvillua njëzet e pesë vjet pas krimeve të kryera tregon se synimi ishte mbulimi i atyre krimeve."*

U.D/Shqiptarja.com

f Share

U.D/Shqiptarja.com

TAG: Gjyqi ndaj UCK ne Hage | Ivica Daçiç

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★ ★ ★ ★ ★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

**Komente**

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH com

**Sondazhi i ditës:** 16 Shtator, 14:18

**Haga dënon me 81 vite burg 4 ish-krerët e UÇK-së, si e vlerësoni?**

Të drejtë | Të gabuar | Nuk e di

## Lajme të tjera



**Protestuesit 5 net në shesh kundër vendimit të Hagës, 'skuqet' Prishtina! Shpaloset flamuri Kombëtar gjigant, kërkohet drejtësi për 4 ish-krerët e UÇK (VIDEO)**

20 Shtator, 21:28



**Dënimi me 81 vite burg i 4 ish-krerëve të UÇK, shqiptarët protestë edhe në Vjenë të Austrisë: O Hashim, ti ku je, krejt Kosovën këtu e ke! (VIDEO)**

20 Shtator, 16:25



**Njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit**

20 Shtator, 15:11



**Verdikti i Hagës ndaj krerëve të UÇK-së, Tedi Blushi kërkon interpelancë me Ramën: Çfarë hapash do ndërmarrë Qeveria për rrëzimin e aktgjykimit?**

20 Shtator, 13:40



**Vuçiç akuzon Perëndimin për standarde të dyfishta: Për Mlladiçin na sulmuan, për Thaçin heshtën**

20 Shtator, 10:50



**A ishte paralajmëruar dënimi i ish-krerëve të UÇK-së? Kryeprokurori i Speciales më 2020: Do burgosen përjetë**

20 Shtator, 08:54



5 ditë pas vendimit të Hagës, Prishtina sërish në shesh: Na ka bashkuar UÇK-ja! Tubime edhe në Gjermani, Zvicër, Austri e Kanada (VIDEO)

20 Shtator, 07:15

Vendimi ndaj ish krerëve të UÇK-së, Kurti nga SHBA: Duhet strategji shtetërore dhe bashkëpunim me aleatët tanë ndërkombëtarë

19 Shtator, 22:52

Pas Hagës, kush do ta çojë përpara drejtësinë për krimet e luftës në Ballkan?

19 Shtator, 21:58

Dënimi i liderëve të UÇK, Prishtina sërish në protestë! Tubime në Gjermani e Austri

19 Shtator, 21:43

Pandeli Majko: Ku gabuam...?

Pandeli Majko

19 Shtator, 19:22

Adri Nurellari: Pas deklaratës së Kuvendit tek veprimi, çfarë duhet të bëjë Shqipëria për Kosovën

Adri Nurellari

19 Shtator, 18:58



[Shqiptarja.com]

Kerko

© 2011 - 2026 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.